

TERMAT DHE KUSHTET E FUSHATËS PROMOCIONALE
VIVAX TEKNIKA E BARDHË MONTUESE – 3+2 vite Garancion

ASK TEC d.o.o. me NUI 810811324 dhe me seli të regjistruar në Rr. Ferid Curri Hyrja C-Lok 2/1 Lok 3/1, Arbëria – 10000 Prishtinë, organizon fushatë promociionale për teknikë e bardhë montuese të brendit VIVAX, ku me blerjen e ndonjë modeli nga gama e teknikës së bardhë montuese në çdo pikë të shitjes së partnerëve të VIVAX në Kroaci, Bosnje dhe Hercegovinë, Serbi, Mal të Zi, Maqedoni të Veriut, Kosovë, Shqipëri, Slloveni, Poloni, Hungari, Republikën Çeke, Gjermani, Itali, Rumania dhe Sllovaki, klientët fundor do të përfitojnë garancion nga prodhuesi prej 3+2 vite.

Termat dhe Kushtet e garancionit 3+2 vite për VIVAX Teknikë e bardhë montuese (në vijim: Kushtet).

Të gjithë klientët fundor që brenda periudhës 1 Korrik deri më 30 Shtator 2025, bëjnë blerjen e ndonjë modeli të enëlarëve montuese VIVAX dhe regjistrohen jo më vonë se 30 ditë nga data e blerjes në web faqen vivax.com, do të fitojnë një garancion nga prodhuesi prej 3+2 vite.

Regjistrimi online bëhet duke i shënuar të dhënat personale të mëposhtme, si:
Emri dhe mbiemri, adresa, qyteti, e-mail adresa, emri i modelit të pajisjes së blerë, numri serial i pajisjes, pika e shitjes ku është blerë pajisja, data e blerjes dhe data e regjistrimit online.

Duke u regjistruar në web faqe, klientëve fundor ju mundësohet të ushtrojë të drejtën për një garancion shtesë, ndërsa të dhënat personale përpunohen në përputhje me dispozitat e këtyre kushteve dhe dispozitat e Politikës së Privatësisë së ASK TEC d.o.o.

ASK TEC d.o.o. rezervon të drejtën, në çdo kohë, për arsye të justifikuara, të bëjë ndryshime në këto Terma dhe Kushte, me detyrimin të publikimit pa vonesë.

NJOFTIM PËR MBLEDHJEN DHE PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE

Të dhënat personale të klientëve fundor do të mbliidhen dhe përpunohen në përputhje me këtë Njoftim, Termat dhe Kushtet e fushatës promociionale VIVAX – Garancion 3+2 vite, Politikën e Privatësisë së ASKTEC d.o.o. e cila gjindet në linkun <https://vivax.com/al/mallra-te-bardha-te-ndertuara-5-vjet-garanci/> si dhe në përputhje me rregulloret përkatëse të Republikës së Kosovës për mbrojtjen e të dhënave personale.

Qëllimi i mbledhjes së të dhënave personale të klientëve fundor është në lidhje me verifikimin e përmbushjes së kushteve për pjesëmarrje në fushatën promociionale dhe me qëllim të përmbushjes së detyrimeve kontraktuale.

Të dhënat personale të përdoruesëve, si: Emri dhe mbiemri, adresa, e-mail adresa, që do të mbliidhen në kuadër të fushatës promociionale, do të jenë në dispozicion të subjekteve të mëposhtme:

- ASK TEC d.o.o. në cilësinë e kontrolluesit të të dhënave personale.
- Partnerët kontraktual të ASK TEC d.o.o. dhe nënkontraktorët në cilësinë e përpunuesëve të dhënave personale me qëllim të regjistrimit të pjesëmarrësve.

ASK TEC d.o.o. konsiderohet kontrolluesi për sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale të përdoruesëve. Mbledhja e të dhënave personale në kuadër të përpunimit në fjalë kryhet në bazë të një kontrate. Në rast se përdoruesi përfundimtar vendos të mos ndaj të dhënat e tij personale me ASK TEC d.o.o., nuk do të ketë mundësi që të marr pjesë në fushatën promociional në fjalë, prandaj nuk do të jetë në gjendje të ushtroj të drejtën e tij për një garancion shtesë.

ASK TEC d.o.o. do të ruaj të dhënat personale të marrura për një periudhë prej pesë vitesh nga momenti i regjistrimit.

ASK TEC d.o.o. me kërkesë të përdoruesëve fundor, do të ju mundësoj të ushtrojnë të drejtat e tyre të aksesit dhe transportueshmërisë, si dhe të drejtën për të plotësuar, korrigjuar, fshirë ose kufizuar përpunimin e të dhënave personale, në përputhje me kushtet e Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave.

Ju mund të paraqisni një kërkesë për ushtrimin e të drejtave tuaja tek Zyrtari i Mbrojtjes së të Dhënave në info@asktec-ks.com ose me shkrim në adresën e zyrës së regjistruar të ASKTEC d.o.o. me treguesin "n/r i Zyrtarit të Mbrojtjes së të Dhënave". Nëse ju, si subjekt i të dhënave, nuk jeni dakord me përpunimin e të dhënave dhe ushtrimin e të drejtave tuaja, mund të kontaktoni gjithashtu Autoritetin Kompetent Mbikëqyrës ose Autoritetin Kryesor Mbikëqyrës për mbrojtjen e të dhënave personale, i cili në këtë rast konsiderohet të jetë Agjencia e Mbrojtjes së të Dhënave Personale në Republikën e Kosovës.

Të gjitha të dhënat tjera dhe informacionet shtesë në lidhje me përpunimin e të dhënave tuaja personale dhe të drejtat përkatëse mund të gjeni në linkun <https://vivax.com/al/politika-e-privatesise-dhe-mbrojtjes-se-te-dhenave-personale/>

Në Prishtinë, 30.06.2025